



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1776/5 prot.

Tiranë më 23.11.2022

VENDIM

Nr. 49, datë 23.11.2022

PËR KONTROLLUESIN “KLEA BURHANLI”
(YKM TURKISH BEAUTY SALON)

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Klea Burhanli*” (YKM Turkish Beauty Salon, (në vijim, “*Kontrolluesi*”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 177, datë 17.10.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisionerit*”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, me fokus të veçantë masat tekniko – organizative për përpunimin e të dhënave personale të tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë (SMSI).

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një qendër estetike dhe estetikë mjekësore që ushtron veprimtari të ndryshme në fushën e mjekësisë dhe shëndetit, në përputhje me autorizimet dhe akreditimet publike të parashikuara nga legjislacioni mjekësor. Shërbimet e ofruara përfshijnë trajtimet estetike, ndërhyrjet, mjekësinë estetike, etj. Kontrolluesi “*Klea Burhanli*” (Ykm Turkish Beauty Salon), ushtron veprimtarinë si person fizik (p.f.).

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave personale si: “*klientë*”, “*punëmarrës*”, “*vizitorë*”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi kryen marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave “*Klientë*” nëpërmjet platformës “*Whatsapp*”. Konkretisht, Kontrolluesi ruan në aparatën telefonik të biznesit, të gjithë numrat e kontaktit që ka nga klientët, të cilët kanë kryer një shërbim pranë kësaj klinike, dhe më pas i përdor këto kontakte jo vetëm me qëllim për të komunikuar me klientët në funksion të shërbimit që ata kërkojnë të marrin, por edhe për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë.

Konkretisht, Kontrolluesi në mënyrë të herë pas hershme dërgon drejt klientëve mesazhe promocionale, lidhur me trajtimet që kryen në qendër dhe ofertat që aplikon. Në rastin e përdorimit të numrave të kontaktit të klientëve, për të realizuar marketingun e drejtpërdrejtë, Kontrolluesi nuk aplikon/provon marrjen e pëlqimit prej tyre, për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky konstatim vjen në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së përpunimit, të sanksionuar në germën “*b*” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit e cila përcakton se, mbrojtja e të dhënave personale bazohet në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime.

Gjithashtu, ky konstatim vjen në kundërshtim me kriteret ligjore të përpunimit të sanksionuara në pikën 1/a, dhe pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me parashikimin e Kreut I, të Udhëzimit nr. 16 datë 26.12.2011, për “*Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë*”. Dispozitat e sipërcituara përcaktojnë qartazi se mbledhja e të dhënave personale, që lidhen në mënyrë unike me një subjekt të dhënash, për arsye të tregtimit të drejtpërdrejtë, lejohet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e shprehur qartë.

3. Kontrolluesi disponon faqen online <https://ykm.al>, në të cilën konstatohet se nuk është publikuar rubrika “*Politikat e Privatësisë*”, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin që do t’i përpunojë, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Njëkohësisht, përmes kësaj faqe Kontrolluesi ka krijuar mundësinë e aplikimit për të rezervuar një vizitë pranë mjekut apo estetistit, në formën e kontaktit “*Rezervo një vizitë*”. Konstatohet gjithashtu se, edhe përmes kësaj rubrike nuk realizohet informimi i subjekteve të të dhënave sipas parashikimit ligjor të mësipërm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me Kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës “*Politikat e Privatësisë*” në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të tilla si: rezervimi i takimeve përmes faqes, kontakt, etj.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (*korridoret, dera e jashtme dhe ambientin e receptionit*), për qëllim të sigurisë së personelit dhe pronës. Konstatohet se, Kontrolluesi ka vendosur një tabelë informuese lidhur me prezencën e sistemit të video survejimit (CCTV), por informimi mbi përpunimin e të dhënave përmes kësaj tablele nuk është i plotë.

Formati i tabelës informuese nuk është në përputhje me modelin standard të tabelës informuese të miratuar nga Zyra e Komisionerit, në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar. Gjithashtu, Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

5. Nga verifikimi rezulton se Kontrolluesi ka lidhur kontratë me palë të treta:

- Kontratë me shoqërinë S & E LAZE AUDIT, sh.p.k me objekt *“Ofrimin e shërbimit kontabël dhe konsulencë për përgatitjen dhe hartimin e bilancit Kontabël, Konsulenca Fizike, Konsulenca Financiare”*.

Nga verifikimi i kontratës me palë të treta, rezulton se, nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të sipërcituar, çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*) që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezulton se, Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës sipas përcaktimeve të nenit 21 të Ligjit, i cili parashikon se: *“Çdo Kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për *“Njoftim”* mbi përpunimin e të dhënave personale, si dhe përditësimi i ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

Sipas përcaktimeve të Ligjit, Njoftimi duhet të bëhet para se Kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të këtij Ligji.

7. Kontrolluesi nuk ka hartuar “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale për çdo kategori subjekti të dhënash, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj., si dhe nuk ka nënshkruar “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit, në kundërshtim me parashikimet e neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”), pasi mundëson shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Sa i përket mos-nënshkrimit të “Deklaratës së Konfidencialitetit”, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate, është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull “Deklaratë Konfidencialiteti”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të numrit të numrit të lartë të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi për kategoritë (“klientë”, “punëmarrës”, “vizitorë”), natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit përmes nëpunësit të protokollit të Zyrës së Komisionerit, pranë ambienteve të Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit nuk është paraqitur, pavarësisht ftesës për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, si dhe nuk ka depozituar asnjë pretendim me shkrim lidhur me shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit, apo prova shtesë në kuadër të masave që duhet të marrë për rekuperimin e shkeljeve.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, germat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
- 5- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi të ndalojë menjëherë formën e aplikuar përmes mesazheve promovionale për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, etj., në zbatim të nenit 18 të Ligjit;
- 9- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjen e bashkëpunimit me përpunuesin, duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 10- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për të kryer “Njoftimin” pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës.
- 11- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave

personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;

12- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij;

13- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- i. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 6, 8 dhe 12 më sipër;
- ii. menjëherë, detyrimin e përcaktuar në pikën 7 më sipër;
- iii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 10 më sipër;
- iv. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 9 dhe 11 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

14- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

15- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

16- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 23.11.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi